



**VENDIM**  
**Nr. 39 Datë 05.05.2010**

**PËR**  
**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “SELCA ENERGI” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, neni 5 pika 1 germa “a” dhe neni 17 pika 2 germa “a” dhe “d” të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 05.05.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SELCA ENERGI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

“HEC Selce”, bazuar në Vendimin nr.05, datë 20.01.2010, te Bordit të Komisionereve i është dhene në operim WTS Energji sh.p.k deri në licensimin e personit në pronësi të të cilit është ky HEC.

Me vendimin nr.13 datë 08.02.2010 të Bordit të Komisionereve të ERE-s kanë filluar procedurat për licensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “SELCA ENERGI” sh.p.k, e cila ka në pronësi Hec Selcen.

Aplikimi i shoqërisë “SELCA ENERGI” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa ”a”, ”b” dhe ”c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “a”)

- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma “a”, ”b”, ”c”, ”d”, ”f” dhe ”g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “b”)
- o Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, ”b” dhe ”d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “c”)
- o Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte dhe nuk ka asnjë ndryshim apo modifikim te tij. (Neni 17 pika 2 germa “d”).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Liçensimin e shoqërisë “SELCA ENERGI” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Selce.
2. Afati i vlefshmerisë së licensës të jetë 30 vjet.
3. Shoqëria “SELCA ENERGI” sh.p.k, të fillojë ushtrimin e aktivitetit me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

